3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës.....
Shtojca 1/1. Formulari i Ofertës.....
Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve
Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës.....
Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial
Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike
Shtojca 6. Formulari i sasisë dhe Grafiku i lëvrimit
Shtojca 7. Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes së Ofertuesve
Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit
Shtojca 9. Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....
Shtojca 10. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak).....
Shtojca 11. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)
Shtojca 12. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)
Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 1/1.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në cmim me te ulet]

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë s qarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.

c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

ç) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontrates;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

d) Norma e fitimit e shprehur në vlerë absolute është si më poshtë

1	2	3
Nr	Përshkrimi i mallrave	Norma e fitimit

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE**Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	çmimi per njësi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i mallrave	Specifikime teknike
Bojë printeri / Bojë fotokopje (zërat 1 - 23 të preventivit)	Për sa i përket bojrave të përcaktuara në preventivin e mësipërm për printerat/fotokopjet që AK Bashkia Divjakë disponon, tonerat duhet të jenë bojra origjinale ose ekuivalente, me pullë sigurie, të pahapura dhe jo të rimbushura.

Leter A3	<p>Letrat të jenë origjinale dhe të cilësisë së parë. Të jetë CIE bardhësi 169 ± 3, dimensionet: 297x420mm. Pesha e një fije të jetë 80 gr/m² dhe një rizme (500 fije x A4), Lagështira: 3.5-4.5 %. Trashësia: 104-112μm. Drita : $\geq 94\%$. Shkelqimi : 101-114%, Të mos jete e ricikluar, Letra të ketë mbështjellje kundër lagështirës. Letra të mos bllokojë makinën fotokopjuese apo printerin, fax-in. Të qëndroje e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit. Të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit. Të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët. Të plotësojë standartet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkivë.</p>
Leter format A4 80gsm, (210mm x 297mm)	<p>Letrat të jenë origjinale dhe të cilësisë së parë. Të jetë CIE bardhësi 169 ± 3, dimensionet: 297x210mm. Pesha e një fije të jetë 80 gr/m² dhe një rizme (500 fije x A4), Lagështira: 3.5-4.5 %. Trashësia: 104-112μm. Drita : $\geq 94\%$. Shkelqimi : 101-114%, Të mos jete e ricikluar, Letra të ketë mbështjellje kundër lagështirës. Letra të mos bllokojë makinën fotokopjuese apo printerin, fax-in. Të qëndroje e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit. Të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit. Të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët. Të plotësojë standartet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkivë.</p>
Regjistër korespondence (Protokolli) (100 fq)	<p>Hartuar sipas nenit 19 te NORMAVE TEKNIKO PROFESIONALE DHE METODOLOGJIKE TE SHERBIMIT ARKIVOR NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE , modeli 1 (duhet te jete e shkruajur me cdo flete)</p>

<p>Dosje me mekanizëm (me 20 qese plastike)</p>	<p>Kjo dosje me mekanizëm shërben për të mbrojtur dhe ruajtur të gjitha dokumentet duke i kapur me mekanizëm. Ajo duhet të ketë një mekanizëm metalik, i cili i mban dokumentat të mbërthyera me anë të dy shufrave dopjo në të cilat vendosen letrat A4 pasi janë hapur vrimat përkatëse me hapëse vrimash dopjo ose qeset mbajtëse përkatëse. Gjithashtu, duhet të ketë një etiketë për identifikim të lehtë të kontekstit të dokumenteve përbërëse. Materiali të jete polipropilen me shkelqim. Te jete lehtesisht elastike. Të mbajë jo më pak se 600 fletë me gramaturë 80gm².</p>
<p>Dosje arkive me buton 15 cm</p>	<p>Dosje me buton me thellësi 15±0.5cm, material polipropileni. Kjo dosje me buton shërben për të mbrojtur dhe ruajtur të gjitha dokumentet tuaja të rëndësishme. Gjithashtu, ajo ka një etiketë për identifikim të lehtë të kontekstit të dokumenteve përbërëse. Përmasat 240±5mm x350±5mm. Mundesisht të ketë një vrimë e cila lejon terheqjen e saj sa me lehtë nga arkiva.</p>
<p>Qese plastike Dokumenta A₄ 40 micro (100copë/pako)</p>	<p>Pako me 100 qese plastike prej materiali polipropilen, transparente dhe me madhësi A₄, me spesor jo më pak se 100 mikron. Këto qese mund të përdoren me të gjitha llojet e lidhësve të unazave si një mënyrë për të mbrojtur dhe renditur dokumentet. Çdo qese të ketë kapacitet mbajtës jo më pak se 40 fletë A₄ 80gm² secila.</p>
<p>Letër Plastike (Transparent) A₄ (100 fije/pako)</p>	<p>Letër Plastike/kapak PVC transparent A₄ me trashësi jo më pak se 200 mikron. Paketimi në pako 100 copë.</p>
<p>Letër (Transparent) A₃ (100 fije/pako)</p>	<p>Letër Plastike/kapak PVC transparent A₃ me trashësi jo më pak se 200 mikron. Paketimi në pako 100 copë.</p>
<p>Letër Kartoni A₄ (270 gr) (100 fije/pako)</p>	<p>Letër/kapak kartoni A₄ me masë 270 gm² me ngjyra të ndryshme. Paketimi në pako deri në 100 copë.</p>
<p>Kapëse letrash mesatare metalike 24/6</p>	<p>Makina për kapse aktesh (Stapler), të jetë metalike dhe me material çelik i pandryshkshëm ose i kromuar në formë pince (dore). Makina të jetë përshtatshme për të kapur deri në jo më pak se 45 fletë të gramaturës 80 gr/m². Të përdoret me tela/kapëse 24/6, 26/6, 26/8 dhe 24/8.</p>
<p>Kapse letrash e madhe (deri ne 100 flete)</p>	<p>Makinë kapëse aktesh prej materiali metalik. Makina të jetë përshtatshme për të kapur deri në jo më pak se 100 fletë të gramaturës 80 gr/m². Gjithashtu ajo duhet të kapi dhe me pak fleta në varësi të përdorimit duke ndërruar numrin e telave. Te kete depozite per te vendosur telat. Çdo informacion shtesë për numrin e telave që përdoren në varësi të fletave duhet të jenë të</p>

	shpjeguara dhe në trup të produktit. Telat te jene nga 23/6 deri 23/24.
Kapëse letrash e vogel pince nr 10	Makina për kapse aktesh (Stapler), të jetë metalike dhe me material çelik i pandryshkshëm ose i kromuar në formë pince (dore). Makina të jetë përshtatshme për të kapur deri në jo më pak se 20 fletë të gramaturës 80 gr/m ² . Të përdoret me tela/kapëse 23/10.
Tela/kapëse 24/6	Kapëset/tela të jenë të dizajnuara me material të cilësisë së lartë, te galvanizuar dhe të jenë parashikuar për të shpuar pastër përmes fletëve të shumta të letrës pa u këputur ose shqyer letrën. Të jenë prej metali të kromuar ose të pandryshkshëm. Te kapi deri ne jo me pak se 30 flete te gramatures 80gr/m ² . Paketimi 1000 copë.
Tela/kapëse 23/10	Kapëset/tela të jenë të dizajnuara me material të cilësisë së lartë dhe te galvanizuar, të jenë parashikuar për të shpuar pastër përmes fletëve të shumta të letrës pa u këputur ose shqyer letrën. Te kapi deri ne jo me pak se 70 flete te gramatures 80gr/m ² . Paketimi 1000 copë.
Mprehëse lapsash	Mprehës lapsash me dy vrima dhe me depozitë për ashklat e mprehura, po ashtu edhe me gome. Për lapsa deri në Ø11 mm dhe kënd mprehës te ndryshem. Thikat e mprehjes të jenë metalike të kromuara ose metal i pandryshkshëm.
Kapse flutur 25mm (12 copë/pako)	Ndërtimi i produktit të jetë i fortë dhe i qëndrueshëm që lejon të kapen shumë faqe së bashku për organizimin përfundimtar të dokumentave. Ngjyra e zezë. Paketimi jo më pak se 12 copë.
Kapse flutur 32 mm (12 copë/pako)	Ndërtimi i produktit të jetë i fortë dhe i qëndrueshëm që lejon të kapen shumë faqe së bashku për organizimin përfundimtar të dokumentave. Ngjyra e zezë. Paketimi jo më pak se 12 copë.
Kapse flutur mm 41mm (12 copë/pako)	Ndërtimi i produktit të jetë i fortë dhe i qëndrueshëm që lejon të kapen shumë faqe së bashku për organizimin përfundimtar të dokumentave. Ngjyra e zezë. Paketimi jo më pak se 12 copë.
Korrektor (Zbardhues) stilo	Korrektor në formë stilolapsi që shërben për korrigjimin e gabimeve të bëra gjatë shkrimit. Siguron mbulim të mirë dhe thahet shpejt duke lënë një shtresë të butë mbi të cilën mund të shkruhet sërish.
Stilolapsa ngjyra të ndryshëm	Stilolaps i tipit ballpoint me majë 0.7mm-1mm. Të mos krijojë ngecje apo rrjedhje boje gjatë shkrimit.

Bojë vule	Bojë vule blu për të gjitha llojet e vulave. Bojë e pastër mjedisore dhe shumë rezistente. Jo toksike. Paketimi në shishe plastike jo më pak se 20ml.
Goma	Gomë universale për fshirje lapsi dhe boje. Të jetë e bërë nga materiali gome e bute (jo PVC), e përshtatshme për të fshire dhe njollat me të theksuara të lapsit dhe bojës. Nuk duhet të lerë shenja dhe grimca në fletë pas përdorimit. Pa ftalate dhe lateks.
Lapsa plumbi	Lapsi prej grafiti të jetë i prodhuar nga materiale sintetike, që do të thotë se nuk lëshon cifla në rast se thyhet, si dhe të jetë rezistent ndaj shtypjes dhe përdorimit. Shkalla e grafitit të jetë HB. Lapsat te jene jo toksik.
Mbajtëse dokumentash metalike 3 - she	Mbajtëse dokumentash metalike 3 kate, ngjyrë e zezë, me përmasa 36±1cm x 28±1cm x 30±1cm. Ajo shërben për të vendosur dokumentat e përdorimit të përditshëm dhe është e përshtatshme për zyra. Të jetë tërësisht metalike dhe shumë e qëndrueshme.
USB 8GB	PORT 3.0
Makinë llogaritëse 12 shifra	Makinë llogaritëse tavoline me jo më pak se 12 shifra të shfaqura në ekran. Ekran i madh me pjerrësi të rregullueshme. Burim energjie me bateri dhe diellore. Me opsion Tax+ dhe Tax, po ashtu edhe me opsion për kembimin valutor. Zgjedhje rumbullakimi dhe presje dhjetore. Fikje automatike.
Vizore alumin (mm) 50 cm	Vizore me gjatësi 50 cm prej materiali metalik (alumin) dhe rezistente që nuk thyhet. Te kete kellefin e vet.

Shtojca 6.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

PREVENTIV

Objekti: “Blerje kancelarie për nevojat e Bashkisë Divjakë”.

Nr.	EMERTIMI	Njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	Bojë printeri Samsung M 2070 XPRESS (ose ekuivalente)	Cope	30		
2	Bojë printeri Samsung M-2026 (ose ekuivalente)	Cope	30		
3	Bojë printeri Xerox 2010 (ose ekuivalente)	Cope	2		
4	Bojë printeri Samsung M-2022 (ose ekuivalente)	Cope	25		
5	Bojë printeri Samsung SCX -4300 (ose ekuivalente)	Cope	2		
6	Bojë printeri HP Laserjet -5350 -DN (ose ekuivalente)	Cope	5		
7	Bojë printeri Versaling C 7025 (e zeze) (ose ekuivalente)	Cope	4		
8	Bojë printeri Versaling C 7025 (blu) (ose ekuivalente)	Cope	2		
9	Bojë printeri Versaling C 7025 (roze) (ose ekuivalente)	Cope	2		
10	Bojë printeri Versaling C 7025 (verdhe) (ose ekuivalente)	Cope	2		
11	Bojë fotokopje Toshiba e-Studio- 167 (ose ekuivalente)	Cope	4		
12	Bojë printeri Kyoçera Task Afla 2200 (ose ekuivalente)	Cope	5		
13	Bojë Fotokopje Kyoçera FS-6525- MFP (ose ekuivalente)	Cope	25		
14	Bojë printeri Kyoçera 2553 CI (e zeze) (ose ekuivalente)	Cope	20		
15	Bojë printeri Kyoçera 2553 CI (blu) (ose ekuivalente)	Cope	5		
16	Bojë printeri Kyoçera 2553 CI (e verdhe) (ose ekuivalente)	Cope	5		
17	Bojë printeri Kyoçera 2553 CI (roze) (ose ekuivalente)	Cope	5		
18	Bojë printeri Brother HL-5350-DN (ose ekuivalente)	Cope	15		
19	Bojë printeri Brother MFC 895 ODW (ose ekuivalente)	Cope	5		
20	Bojë printeri Brother MFC L2752 DW (ose ekuivalente)	Cope	10		
21	Bojë printeri Xerox - B 205 (ose ekuivalente)	Cope	15		
22	Bojë printeri Xerox - 3124 (ose ekuivalente)	Cope	20		
23	Bojë printeri Ricoh SP 211 54 (ose ekuivalente)	Cope	10		
24	Boja Tush permanent (Evidenciatore Roze)	Cope	100		
25	Boja Tush permanent (Evidenciatore te Verdhe)	Cope	100		
26	BOJRA uji me ngjyra 12 – ce	Pako	70		
27	Bojë vule	Cope	30		
28	Lapustila me ngjyra të ndryshme (Markera permanent)	Cope	70		
29	Lapustila për derrasë (Marker whiteboard)	Cope	50		
30	Korektor (Zbardhues) Stilo	Cope	100		
31	Sprajte 200 ml (Ngjyra e kuqe), Piketim në terren	Cope	20		

32	Plasteline (10 cope/ pako)	Pako	60		
33	Letër Format A ₄ 80 gsm (210 x 297 mm)	Pako	1500		
34	Letër “ A ₃	Pako	20		
35	Letër Plastike (Transparent) A ₄ (100 fije/pako)	Pako	5		
36	Letër (Transparent) A ₃ (100 fije/pako)	Pako	2		
37	Letër Kartoni A ₄ (270 gr)(100 fije/pako)	Pako	5		
38	Letër “ A ₃ (270 gr) (100 fije/pako)	Pako	2		
39	Letër Postite (50 x 70) (12 copë/pako)	Pako	40		
40	Letër “ (76 x 76) (12 copë/pako)	Pako	100		
41	Letër “ (76 x 125) (12 copë/pako)	Pako	20		
42	Karton me ngjyra te ndryshme (50 cm x 70 cm)	Fije	100		
43	Fleta me xixa (50cm x 70cm)	Fije	100		
44	Blllok shënimesh A ₅ (kapaku i veshur me lëkurë)	Cope	50		
45	Fletore katrore + shkrimi A ₅ (54 flete)	Cope	100		
46	Libër arke (3 kopje)	Cope	5		
47	Libër poste (100 fq)	Cope	5		
48	Regjistër korespodence (Protokolli) (100 fq)	Cope	20		
49	Ditar Master mesatar (33 rreshta x 19 kolona)	Cope	10		
50	Ditar Master të mëdhenj (33 rreshta x 36 kolona)	Cope	10		
51	Dosje kartoni (të thjeshta)	Cope	2000		
52	Dosje kartoni llastik plastik 1cm	Cope	300		
53	Dosje kartoni llastik plastik 2.5CM	Cope	100		
54	Dosje kartoni llastik plastik 5cm	Cope	100		
55	Dosje kartoni llastik plastik kuti mesatare 10cm	Cope	100		
56	Dosje arshive me buton 15 CM	Cope	100		
57	Dosje me mekanizem (me 20 qese plastike)	Cope	100		
58	Zarfa të vegjël (11 x 23)	Cope	2000		
59	Zarfa te mëdhenj A ₄	Cope	3000		
60	Zarfa A ₃	Cope	200		
61	Qese plastike Dokumenta A ₄ 40 micro (100copë/pako)	Pako	40		
62	Lapsa plumbi	Cope	200		
63	Stilolapsa ngjyra të ndryshëm	Cope	1000		
64	Lapsa me ngjyra (12 cope / pako)	Pako	50		
65	Rapidograf ngjyrë (blu, kuq, zi) pilot 0.5 (12 cope/pako)	Pako	20		
66	Vizore plastike (mm) 30 cm	Cope	50		
67	Vizore alumin (mm) 50 cm	Cope	10		
68	Goma	Cope	100		
69	Gërshërë	Pale	10		
70	Prehse lapsash	Cope	20		
71	Vinovil (100 gr)	Cope	50		
72	Shina plastike (3, 6, 8 mm) (100*3)	Cope	300		
73	Mbajtëse dokumentash metalike 3 - she	Cope	20		
74	Mbajtëse kancelarish rrjete 3 vende (Lapsa)	Cope	20		
75	Kapse letrash e madhe (deri ne 100 flete)	Cope	4		
76	Kapëse letrash mesatare metalike 24/6	Cope	10		

77	kapëse letrash e vogel pince nr 10	Cope	20		
78	Hapse letrash (telash) 2 vrima metalike	Cope	50		
79	Tela kapese 23/10	Pako	100		
80	Tela 24/6	Pako	100		
81	Tela nr 10	Pako	100		
82	Kapse paper nr 3	Pako	150		
83	Kapse “ Nr 4	Pako	150		
84	Kapse “ Nr 5	Pako	150		
85	Kapëse flutur 25 mm (12copë/pako)	Pako	150		
86	Kapëse flutur 32 mm (12copë/pako)	Pako	100		
87	Kapëse flutur 41 mm(12copë/pako)	Pako	100		
88	Makinë llogaritëse 12 shifra	Cope	20		
89	USB 8 GB	Cope	2		
90	USB Wireless (lidhje interneti)	Cope	2		
91	Disqe CD + zarfa	Cope	50		
92	Disqe DVD	Cope	50		
93	Ngjyra (6 te ndryshme)	Pako	50		
94	Fleta dizanjo	Cope	100		
95	Bojra Akuarele	Cope	50		
96	Bojra Plastike + Penela	Cope	50		
97	Bojra vaji	Cope	20		
98	Penela per bojra vaji	Cope	50		
99	Kuti pastele	Cope	50		
100	Ngjites letre per afishime	Cope	10		
	SHUMA				
	T.V.SH 20%				
	TOTALI (SHUMA + T.V.SH 20%)				

Shënim: Për sa i përket bojrave të përcaktuara në preventivin e mësipërm për printerat/fotokopjet që AK Bashkia Divjakë disponon, operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë me anë të një deklarate, se tonerat do të jenë bojra origjinale ose ekuivalente, me pullë sigurie, të pahapura dhe jo të rimbushura.

Afatet e lëvrimit: 14 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
1.	“Blerje kancelarie për nevojat e Bashkisë Divjakë”	2 024 824 (dy milion e njëzetë e katër mijë e tetëqind e njëzetë e katër) lekë pa Tvsh.	Bashkia Divjakë	14 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës

Shtojca 7.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas Shtojcës 7, pika 1 "Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit"

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit 2020, 2021 dhe 2022 nga shoqëria, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që po prokurohet.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2022.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Shenim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa

vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me Çertifikatën e cilësisë ISO 9001:2015 (Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë)

(Certifikata si më sipër, duhet të paraqitet origjinale ose kopje e noterizuar, e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, që merr përsipër transportin e mallrave objekt prokurimi, në ambjentet e AK, nga nënshkrimi i kontratës sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë me anë të një deklaratë, se tonerat e kërkuar sipas preventivit, duhet të kenë garanci jo më pak se një vit nga momenti i furnizimit.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të deklarojë me anë të një deklaratë, se tonerat do të jenë bojra origjinale ose ekuivalente, me pullë sigurie, të pahapura dhe jo të rimbushura.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: <ul style="list-style-type: none">Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p>

etj.

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
 - a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
